

VENDIM
Nr.277, datë 18.3.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS BALDUSHK, TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Baldushk, të qarkut të Tiranës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Baldushk të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr.1259, datë 17.9.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Baldushk, të qarkut të Tiranës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Baldushk për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Baldushk

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
811	Prona që përdoren për realizimin e programeve administrative.	Në pronësi
814-829	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
830-837	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
838	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
840,841,842,844,845,846,848,849, 850,851,852,853,854,856,857,858, 859,860,861,862,863,864,866,867, 868,870-881	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
843,847,855,865,869	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
912	Infrastrukturë (Sheshe, lulishte dhe shërbime publike).	Në pronësi
913-1009	Infrastrukturë (Rrugë vendore).	Në pronësi
1010-1051	Varrezat publike.	Në pronësi